

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

V E N D I M

Nr. _____, Datë _____ 2019

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E ARSIMIT SPORTIT
DHE RINISË

“Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë për periudhën
30.07.2017 deri më datën 31.08.2019.

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Tiranë (MASR), rezultoi që në përgjithësi veprimtaria e këtij institucioni është kryer në përputhje me rregullat, kuadrin ligjor dhe dispozitat e tjera që rregullojnë veprimtarinë e MASR-s. Krahas përpjekjeve pozitive u konstatuan dhe të meta dhe mangësi në funksionimin e disa komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, dobësi në zbatimin e dispozitave ligjore dhe akteve në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar, ku veçojmë mosrealizim të fondeve dhe projekteve të parashikuara në Buxhetin faktik, si dhe në fushën e prokurimeve publike për të cilën japim *opinion të kualifikuar*¹.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtorja e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit mbi “*Auditimin Financiar dhe Përputhshmërië*”, të ushtruar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Tiranë, sipas programit të auditimit nr.624/1 prot., datë 04.09.2019 për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri 31.12.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

¹ - Sipas *Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë* të KLSH-së, (fq.65-66), kapitulli V, pika 5.4, “Opinion i kualifikuar”, mund të shprehe një opinion me reserve kur devijimet janë material por jot e perhapura.

A. OPINIONI I AUDITIMIT:

I.Opinion mbi përputhshmërinë (i kualifikuar)

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

Mbështetur mbi punën audituese në përfundim rezultoi se, në opinionin tonë, aktiviteti i MASR-s, me përjashtim të çështjeve të trajtuara në bazën opinionit të kualifikuar, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e vlerësimit, si dhe me parimet dhe rregullat e aplikueshme,

Baza për opinionin e përputhshmërinë²:

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs) mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.208, të Kryetarit të KLSH-së.

Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve, duke vlerësuar materialitetin, risqet dhe kampionin e transaksioneve me kriteret e parashikuara.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti MASR, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e përfutur u evidentua në përgjithësi zbatimi i tyre dhe nuk ka raste mospërputhjes materiale për të raportuar, por u konstatuan edhe devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, ku veçojmë mosrealizim të fondeve dhe projekteve të parashikuara në Buxhetin faktik, si dhe në fushën e prokurimeve publike, ku përlllogaritja e fondit limit kryhet duke marrë oferta të OE të cilët janë në dijeni të të dhënave të tenderit mbi sasinë dhe objektin e detajuar që prokurohet, nuk argumentohet se si u përzgjedhën operatorët ekonomikë që paraqitën ofertat lidhur me objektin e prokurimit, kjo për faktin se janë të njëjtët OE që kanë marrë pjesë dhe janë shpallur fitues të kontratës së prokurimit etj. Auditimi i përputhshmërisë në MASR është kryer bazuar në kriteret e auditimit të përputhshmërisë dhe audituesit nën gjykimin profesional e të pavarur japin opinion të kualifikuar, kur rezultojnë devijime materiale mbi nivelin e materialitetit të llogaritur sipas Aneksit.1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, për të cilën japim **opinion të kualifikuar**³.

II.Opinion mbi pasqyrat financiare (i kualifikuar)

Ne audituam pasqyrat financiare të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve më datë 31.12.2018, të cilat përbëhen nga Bilanci, Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, Pasqyra e Fluksit të Arkës, dhe Pasqyra e Lëvizjes së Kapitalit si dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat.

Në opinionin tonë, transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit dhe pasqyrimi në veprimet përgjatë raportimit financiar dhe janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Megjithatë, nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Standardin ISSAI 1700, u konstatuan edhe anomali në plotësimin e pasqyrave financiare dhe zbatimin e kuadrit ligjor

¹ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".

³ - Sipas **Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë** të KLSH-së, (fq.65-66), kapitulli V, pika 5.4, "Opinionin i kualifikuar", mund të shprehe një opinion me reserve kur devijimet janë material por jot e perhapura.

dhe rregullator në fuqi (të paraqitura më lartë), të konsideruara *materiale, por jo të përhapura, për të cilën japim opinion të kualifikuar*⁴

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 1700 “Standardi i Auditimit të Financiar”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të kualifikuar të auditimit**.

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PERMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të Prokurimit Publik në MASR për vitet 2017-2018 -8-mujori 2019 konstatohet se, metoda e përdorur për përllogaritjen e fondit limit, është metoda e studimit të tregut nëpërmjet ofertave ekonomike të marra pranë operatorëve ekonomikë të regjistruar në QKB, bazuar në nenin 59, pika 2, gërma” a”, të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Referuar materialeve të grupeve të punës të ngritura për hartimin e specifikimeve dhe përllogaritjen e fondit limit, në asnjë rast nuk argumentohet se si u përzgjedhën operatorët ekonomikë nga këto grupe pune, të cilat paraqitën ofertat paraprake me çmime mbi sasinë përkatëse sipas objektit të prokurimit.

Gjithashtu mënyra e komunikimi mes palëve dhe shkëmbimi i informacionit ,në shumë raste nuk dokumentohet, e theksojmë këtë fenomen për faktin se në shumë raste pikërisht për këto procedura janë paraqitur të njëjtët OE (të cilët kanë dhënë çmimet referuese për përllogaritjen e vlerës së kontratës), kanë marrë pjesë dhe janë shpallur fitues të kontratës së prokurimit,ose dhe është paraqitur i vetëm dhe është shpallur fitues, veprime këto që cenojnë parimin e Ligjit për prokurimin publik,lidhur me transparencën që duhet të jetë një nga parimet themelore që duhet të udhëheq çdo AK, në hapat që ndjekin në procedurat e prokurimit publik.

2. Në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

-nga AK në kriteret e kualifikimeve, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, konstatohen raste me kërkesa që nuk nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik.

-parashikimet e nenit 46 të LPP, si dhe nenit 26 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, ku çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore. *Trajtuar më hollësisht në faqet 90-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

⁴. Sipas *Manualit të Auditimit Financiar* të KLSH-së, kapitulli IV, pika 4.2, “Opinionit me rezerve” do të jepet në rastet kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat janë materiale, por jo thelbësore për arsyetimin e pasqyrave. Nëse efekti financiar i paqartësisë apo i mosmarrëveshjes është i përcaktuar si shumë nga audituesi, ndonëse nuk është gjithmonë e praktikuar ose e përshtatshme, atëherë kjo do të shërbejë si ndihmë për përdoruesit e pasqyrave.

1.1. Rekomandimi:

1.1.1- Agjencia e Prokurimit Publik ti propozojë Këshillit të Ministrave, amendime të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 58 “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, duke parashikuar si kërkesë për Autoritet kontraktore, në rastet kur paraqitet ose kualifikohet një ofertues i vetëm në procedurat e prokurimit, këto Autoritete detyrimisht duhet ti drejtohen Autoritetit të konkurrencës si autoritet i pavarur në mbikëqyrjen e konkurrencës në tregjeve, për miratim, para nënshkrimit të kontratës, me qëllim shmangien dhe parandalimin e marrëveshjeve të mundshme mes operatorëve për përfitim të kontratave publike.

1.1.2- Agjencia e Prokurimit Publik të rishikojë mekanizmat e përlogaritjes së vlerës së kontratave nga Autoritetet kontraktore, parashikuar nenin 59, pika 2, germa” a”, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me qëllim shmangien e rasteve e përlogaritjes së fondit limit ndikuar nga OE të cilët duke qenë në dijeni të të dhënave të tenderit mbi sasinë dhe objektin e detajuar që prokurohet, ndikojnë në paravendosjen e vlerave të kontratave dhe shpalljen e fituesit të kontratës së prokurimit.

1.1.3- Agjencia e Prokurimit Publik të rrisi shkallën e ashpërsisë së masave administrative të parashikuara në nenin 72 Kundravajtjet administrative kreu IX të Ligjit për Prokurimin Publik, për rastet ku vendosja e kriterëve kualifikuese janë kërkesa që nuk nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik.

Në vijimësi

C.MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi: *Nga auditimi i Planifikimit të buxhetit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe nivelet e realizimit të planit përfundimtar konstatohet se;*

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në ligjin vjetor të buxheti, fondet për Investime në objektet arsimore, për blerje pajisje mobilie, për blerje pajisje laboratorë fizike kimi biologjie, si dhe blerje pajisje të tjera për arsimin parashkollor, në arsimin parauniversitar, planifikohen me ligjin vjetor, si fonde “grant për arsimin”, pjesë e fondit të zhvillimit të rajoneve. Këto fonde nuk janë miratuar në ligjin vjetor të buxhetit si fonde “grant”, sipas përcaktimeve të ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar por janë miratuar si fonde me destinacion në investim, kur në fakt sipas ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, këto fonde duhet të miratohen me përfitues të drejtpërdrejt Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, dhe jo për Ministrinë e Arsimit.

Pra, investime në infrastrukturën arsimore, janë tanimë funksion i decentralizuar, dhe i takojnë, qartësisht si funksione NJVV ku ka për detyrë të financojë, përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve infrastrukturore godina, ndërtim, rindërtimin, rikonstruksionin, mirëmbajtje, ruajtje, sigurim dhe garantim i funksionimit të shërbimit arsimor, si ujë, elektricitet etj, për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore publike. Fondet për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.

Çdo bashki dhe komunë vendos nivelin e financimit që ajo akordon për këtë funksion nga të gjitha burimet e zotëruara në buxhetin e saj. Ministria përgatit dhe nxjerr standarde kombëtare të sigurisë dhe të shëndetit, të zbatueshme për mjediset e APU-së. Pra, si konkluzion kemi një ndërthurje të kompetencave të qeverisjes qendrore me qeverisjen vendore, të pa ndara qartësisht, ku fondet planifikohen dhe miratohen nga MASR por menaxhohen dhe ekzekutohen nga vetë NJQV, dhe Ministria nuk ushtron më kontroll mbi përdorimin e tyre sipas ciklit të parashikuar në ligjin për MFK. *Trajtuar më hollësisht në faqet 52-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1-Rekomandimi:

-Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Buxhetit, në zbatim të Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, si njësi e cila planifikon dhe miraton fonde në formë grand, për NJQV të ushtrisë të drejtën e kontrollit para ekzekutimit dhe auditore këto fonde në vazhdimësi, duke përbushur ciklin e plotë të MFK.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: *Konstatohet se mosrealizimi e fondeve të planifikuara për 12-mujorin 2018 në shumën 989,308,000 lekë ka ardhur si rezultat i faktorëve të mëposhtëm:*

-Vonesa në shpalljen e thirrjeve dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për fondet e zhvillimit të rajoneve, për projektet e reja për vitin 2018, Vendimi i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve Nr.7 datë 11.5. 2018 në shumën prej 1.5 miliard lekë për projektet e reja për vitin 2018.

-Moszbatimi i grafikut të punimeve për objektet/kontratat nga autoriteti kontraktor në vijim nga viti 2017-2018, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, kontraktorët e punimeve për 8-mujorin e parë Janar- Gusht 2018.

-Zhvillimi i procedurave të prokurimit publik për vitin 2018, si dhe lidhja e kontratave është realizuara 12-mujorin e parë 2018, me ndikim dhe risk të lartë në realizimin e fondeve për vitin 2018.

Fondet e miratuara për bursat e studentëve, nuk janë realizuara për shkak grevës studentore, kohën e pamjaftueshme të studentëve për tu pajisur me dokumentacion vërtetues të gjendjes së tyre social-ekonomike të lëshuara nga njësitë e qeverisjes vendore për vitin 2018, sipas Vendimit nr.903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave, studentët nuk arritën të aplikojnë për të përfituar bursat në vijim nga viti akademik 2018-2019, me Vendime të KM këto procedura janë shtyrë për riaplikim në janar 2019.

-Disa procedura prokurimi të cilat kishin afate, nuk janë realizuar për shkak të situatës së grevës studentore në dhjetor 2018.

-Fondi prej 88 milion lekë i parashikuar si “Grant për Zhvillimin Institucional 2019”, sipas nenit 111 të ligjit 80/2015, nuk u shpërnda në projekte fituese 2019.

-Fondet e miratuara për vitin 2018, për projektin “Rikualifikim i ndërtesave të UPT-së, Fakulteti Inxhinierisë Mekanike dhe Fakulteti Inxhinieri Elektrike”, nuk janë realizuar.

-Fondet e miratuara për “Rikonstruksion i ndërtesës së korpusit kryesor”, Universiteti i Arteve Tirane, procedura e bllokuar në APP dhe KPP. Të tjera projekte me financim të huaj, të cilat për shkak të situatës në dhjetor 2018, nuk janë realizuar. *Trajtuar më hollësisht në faqet 52-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1-Rekomandimi:

Me qëllim respektimin e parimeve të qeverisjes buxhetore të cilat përbëjnë një “*praktikë të mirë*” për tu ndjekur dhe zbatuar, por edhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, rekomandojmë marrjen e masave nga MASR, që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore të mbahet parasysh, planifikimi, menaxhimi dhe monitorimi aktiv i projekteve buxhetore, në funksion kjo të realizimit të produkteve të parashikuara e të miratuara, të cilat janë jetike për sistemin arsimor në Shqipëri.

Në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: *Konstatohet se mosrealizimi e fondeve të planifikuara për 8- mujorin 2019 në shumën 15,977,379 lekë ka ardhur si rezultat i faktorëve të mëposhtëm:*

Vonesa, në shpalljen e thirrjeve dhe vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për , Vendimi i Komitetit për Zhvillimit e Rajoneve Nr. 2 datë 27.3.2019 për 33 projekte me vlerë të plotë 2.4 miliard lekë dhe financim vjetor 2019 në shumën 672.3 milion lekë.

Projektet e paraqitura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë cilësi jo të mirë projektimi, duke shkaktuar jo vetëm vonesa në prokurim, por dhe kërkesa për të rishikuar projektin , kërkesa për të shtuar punime të paparashikuara, etj.

Shpallja me vonesë e procedurave të prokurimit nga NJVV, apo institucionet pas tre apo katër muajve.

Mosshpallja e procedurës së prokurimi duke riskuar e “djegur” fondet Bashkia Durrës projekti i shkollës 9-vjecare “Jusuf Puka“, Universitetit i Tiranë “Projekti reahlibilitimi i Sheshit të Fakulteti i Histori -Filologjisë”.

Pezullimi nga KPP për disa procedura si në Universitetin e Arteve Tiranë, Bashkia Përrenjas Projekti “Ndërtimi i Fushës së Sportit”.

Mosreliazimi i grafikut të punimeve për objektet/kontratat nga autoriteti kontraktor në vijim, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore/Kontraktorët e punimeve.

Pezullimi apo mosvijimi i punimeve pa asnjë shkak nga autoriteti kontraktor.

Mosrealizimi i shpenzimeve korente, është përshkak të zhvillimit të procedurave të prokurimit në disa produkte/ aktivitete, si trajnimi i mësuesve.

Mosrealizimi i shpenzimeve korente artikulli 604 “Fonde grant për IAL publike”, miratuar me VKM nr.119, datë 13.03.2019 “Për një shtesë fondi nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2019, dhe rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, për Ministrinë e Arsimit janë shtuar 1 miliard e 700 milion lekë, fondet për IAL publike në kuadër të “Paktit me Universitetet 2019”, deri në vendimarrjen nga organet kolegjiale ky fond për 8-mujorin e parë 2019.

Mosreliazimi i shpenzimeve korente, është përshkak të zhvillimit të procedurave të prokurimit në disa produkte/ aktivitete, si transporti i mësuesve dhe nxënësve.

Mosreliazimi i shpenzimeve korente , përshkak të zhvillimit të procedurave për blerjen e teksteve shkollore për nxënësit e arsimit parauniversitar, produkte/aktivitete, veprimtari të planifikuara për 4 mujorin e tretë 2019. *Trajtuar më hollësisht në faqet 52-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi:

- MASR në bashkëpunim me strukturat në NJQV të kërkojë vazhdimisht nga Bashkitë projekte të plota dhe me të gjitha elementët e një projekti me qëllim shmangien e rritjes së kostove dhe problematikave në zbatimin e tyre, pa sjellë vonesa në realizimin e veprave të cilat projektohen dhe financohen për të rritur mirëqenien dhe zhvillimin e komuniteteve.

MASR të kërkojë vazhdimisht nga NJQV-së, zbatimin e raportit në përqindje të financimit të investimit për përfundimin dhe zbatimin e objekteve, nga NJQV-së, për përfundimin e çdo procedure të prokurimit në kohë, ku mosplotësimi i elementëve të mësipërm të parashikohet si kusht s’kualifikues për përfitimn e financimit të projekteve nga këto NJQV.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: *Nga auditimi i pasqyrave financiare* rezulton se, nga subjekti për vlerën e klientëve dhe furnitorëve nuk është dërguar letër konfirmimi për llogaritë e pagueshme, për të verifikuar nëse vlerat e tyre janë në përputhje me shënimet e kontabilitetit. Mos rakordimi me klientët dhe furnitorët mundëson edhe riskun e pagesave të parregullta, si dhe prezantimin jo të saktë e të plotë të detyrimeve në pasqyrat financiare. *Trajtuar më hollësisht në faqet 75-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi:

Drejtesit e MASR, sektori i financës në miratimin e pasqyrave financiare, duhet të konfirmojnë (rakordojnë) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër me qëllim, rregullaritetin e operacioneve të origjinës së tepricave të regjistruara në kontabilitet që të sigurohet se këto operacione kanë të bëjnë me kuadrin normal të lidhjeve të furnitorit me klientin, dhe të sigurohet nëse shumat përkatëse janë transferuar në llogaritë e debitorëve sipas natyrës së operacioneve.

Të përcaktojnë rregullat që forcojnë kontrollet e brendshme lidhur me rakordimin dhe raportimin e detyrimeve për faturat e papaguara dhe raportimin e tyre në mënyrë rigorozë mbi baza mujore e vjetore, sipas përkatësisë së vitit buxhetor kur ato krijohen dhe likuidohen.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: *Nga auditimi i pasqyrave financiare* konstatohet se Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” si llogari specifike në sektorin publik, në kredi të saj përfaqësohen të hyrat (të ardhurat) që vijnë në llogarinë e thesarit të institucioneve që në një periudhë tjetër do t’u kthehen nga kjo llogari të tretëve dhe duhet të vërtetohen me akt-rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt-rakordim, tepricat nuk janë paraqitur dhe strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet). *Trajtuar më hollësisht në faqet 75-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandimi:

Tepricat e llogarisë 520, “Disponibilitete në thesar” dhe të llogarisë 466, “Kreditorë për mjete në ruajtje” të vërtetohen me akt-rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt-rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet).

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: *Nga auditimi i pasqyrave financiare* Format 5 “Shënimit shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore” është plotësuar relacioni shpjegues por nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar ku të japin informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë. *Trajtuar më hollësisht në faqet 75-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1.Rekomandimi: Të merren masat për plotësimin e pasqyrave financiare me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare vjetore me informacion sqarues, përveç atij që paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimit të aktiveve. Shënimet të japin përshkrime me fjalë apo zbërthime të zërave të paraqitur në këto pasqyra apo evidentojnë problemet që mund të kenë rezultuar gjatë fazës së përgatitjes apo të paraqitjes së pasqyrave financiare vjetore, për të arritur paraqitjen e drejtë në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

Në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se MASR nuk ka kryer procesin e inventarizimit përpara mbylljes së llogarive vjetore për vitin 2017 dhe vitin 2018, në bazë të të cilit të evidentohet gjendja fizike e aktiveve dhe krahasimi i tyre me gjendjen kontabël. Ndërsa për vitin 2017 procesi i inventarizimit nuk është kryer, për vitin 2018 ky proces është kryer me vonesë, kundrejt mbylljes së pasqyrave financiare. Nëse pasqyrat financiare vjetore të Aparatit të MASR, janë nisur në MFE me shkresën nr. 3439, datë 26.03.2019, procesi i inventarizimit referuar Urdhrit të Ministrit të MASR, nr. 293, “Për inventarizimin e vlerave

materiale” mban datën 28.05.2019 duke vërtetuar kryerjen pas mbylljes vjetore të llogarive. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar Neni 7, Pika 1 dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të qeverisjes së përgjithshme”, Kreu 3.1, Pika 30. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 66-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi:

-MASR të marrë masat që përpara raportimit të pasqyrave financiare të institucionit, të kryejë inventarizimin dhe të bëjë rakordimin e gjendjes fizike me gjendjen kontabël, në funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së aktiveve në pronësi të saj.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se Komisioni i Inventarizimit për vitin 2018, i ngritur me Urdhrin e Ministrit nr. 293, datë 28.05.2019 “Për inventarizimin e vlerave materiale”, ka patur në përbërje Drejtuesin e Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, Drejtori e cila në varësi të saj sipas strukturës organike të ministrisë, ka Sektorin e Administrimit të Aseteve dhe Shërbimeve të Përgjithshme, dhe ndër 4 anëtarët e Komisionit, njëri është specialist i sektorit të financës. Në praktikën e inventarizimit nuk u konstatua firmosja e deklaratave të mungesës së konfliktit të interesit, në kushtet ku është verifikuar ekzistenca dhe plotësia e aktiveve nga punonjësit që i kanë në ngarkim apo i kontabilizojnë ato. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Neni 22 Veprimtaritë e kontrollit, Pika 3/b dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kreu Përgjegjësitë për inventarizimin, Pika 82. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 66-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandimi:

-MASR të marrë masat që në ngritjen e komisionit të inventarizimit të verifikojë dhe vërtetojë mungesën e konfliktit të interesit, për të ruajtur plotësinë e aktiveve dhe regjistrimin e duhur në dokumentet kontabël.

Në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i regjistrit të aktiveve të MASR, u konstatua se institucioni nuk ka një regjistër të plotë të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, në të cilin të evidentohet qartësisht data e hyrjes në institucion, amortizimi akumuluar, amortizimi vjetor dhe vlera e mbetur, sipas formatit të regjistrit të aktiveve. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu Regjistri i aktiveve të njësisve të sektorit publik, Pika 26, 28 dhe 30. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 66-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1.Rekomandimi:

-MASR të marrë masa për nxjerrjen e një regjistri të plotë të aktiveve që zotëron, sipas llojit, grupit dhe formatit të dispozitave ligjore në fuqi në funksion të evidentimit të jetëgjatësisë së përdorimit të aktiveve nga institucioni dhe monitorimit të llogaritjes së amortizimit vjetor.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së inventarizimit të aktiveve të realizuar nga komisioni i inventarizimit, për vitin 2018 ka konstatuar diferenca, për të cilat janë nxjerrë personat përgjegjës. Diferencat e konstatuara komisioni i ka cituar në procesverbalin përfundimtar, nëpërmjet të cilit vihet në dijeni instancat përkatëse, por për to nuk janë marrë veprime e duhura të mëtejshme. Veprimi bie në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Pika 87, “NA me të marrë dokumentacionin e inventarizimit, nxjerr urdhrin për ndjekje nga Nëpunësi Zbatues në lidhje me masat për kompensimin dhe sistemimin e diferencave të rezultuara”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 66-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1.Rekomandim:

-Nga MASR të merren masat e mëtejshme për kompensimin e vlerës së mbetur të këtyre aseteve dhe sistemimin e diferencave të konstatuara.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2017 janë bërë transferime kapitale 458 njësi aktivesh në vlerën kontabël 16,245,840 lekë. Në praktikën e vënë në dispozicion nga sektori i financës konstatohet vetëm Urdhri i Ministrit nr. 36, datë 31.01.2017 “Për kalim kapital të pajisjeve”, në disa institucione buxhetore. Në praktikë nuk ndodhej procesverbali i vlerësimit të aktiveve, nga një komision i ngritur posaçërisht për vlerësimin e tyre, procesverbali i dhënies në përdorim të aktiveve hartuar nga një komision i posaçëm për tjetërsimin/ dhurimin e aktiveve, kërkesa e njërive përfituese për pajisje dhe as fletë hyrja në njësitë përkatëse. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 Kreu Dhënia në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve Pika 107, 108, Kreu Procesverbali për dhënien në përdorim/tjetërsimin e aktiveve dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, Pika 110, dhe Pika 56. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 66-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1.Rekomandimi:

-MASR të marrë masat që në transferimet kapitale të ndjekë procedurë të plotë të vlerësimit nga një komisione të posaçëm për vlerësimin dhe dhurimin, sipas dispozitës ligjore në fuqi, si dhe të plotësojë praktikën e kryer të transferimit kapital të vitit 2017 me fletë hyrjet përkatëse të njërive pritëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe likuidimet e kryera nëpërmjet bankës, vlera për likuidim për 11 punonjës të larguar padrejtësisht nga puna është në shumën 46,699,644 lekë për periudhën në auditim. Shumat e detyrimeve për vendimet gjyqësore të paguara nga buxheti i shtetit për vitin 2017 janë në vlerën 20,646,317 lekë dhe për vitin 2018 në vlerën 21,086,268 lekë, dhe mbetur për tu shlyer në 2019 vlera prej 4,967,059 lekë. Për të gjitha këto vendime edhe pse kanë qenë të formës së prerë, të gjitha pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga MASR, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbartuesit privat, ku është paguar nga buxheti i shtetit kosto shtesë në shumën prej 2,401,276 lekë për tarifa përmbartimore.

Nga MASR , nuk janë programuar drejt që në projektbuxhet nevojat për shpenzimet gjatë vitit për vendimet gjyqësore të punonjësve të larguar nga puna, megjithëse ato janë të evidentuara, gjatë vitit janë bërë shtesa fondesh me Akte normative dhe rialokime (rishpërndarje fondesh) në shuma të mëdha . Në këto kushte MASR ka pasur të evidentuara vendimet gjyqësore dhe shumën për likuidim dhe nuk i ka parashikuar këto detyrime, duke rritur detyrimet në periudhat e ardhshme.

Për të gjithë sistemin arsimor, jo vetëm për aparatën, kjo vlerë vjen duke u rritur nga viti në vit sepse vazhdon të ketë largime të padrejta nga puna të mësuesve të cilët fitojnë gjyqin dhe normalisht kërkojnë dëmshpërblim. Kjo duket si diçka e “parëndësishme”, por në thelb ajo dëmton rëndë imazhin e sistemit arsimor dhe vlerat që duhet të përçojë ai. Sipas planit të masave të marrë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura që vijnë nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me shkresën nr. 9971/7, datë 20.9.2018, , si dhe shkresën nr. 11422/1, datë 14.11.2018 të destinuara për likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, MASR ka kërkuar fonde shtesë për likuidim të vendimeve për Drejtoritë dhe Zyrat Arsimore, në vlerë totale 70,701,105 lekë, vetëm për vitin 2018 dhe e thënë në mënyrë të përmbledhur vetëm MASR për një periudhë 4 vjeçare ka realizuar pagesa për likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për periudhën 2014-2018, në masën 163.6 milion lekë. Referuar numrit të punonjësve konstatohet se në MASR (sistemi në total) janë 120 vende vakant. Pra, edhe fondi i pagave është llogaritur mbi një strukturë me këto vende

vakant, nga të cilat rezulton e pa domosdoshme plotësimi i këtyre vendeve dhe flet se puna në MASR mund të kryhet edhe në mungesë të 120 punonjësve. Në MASR (aparati) deri në shtator të 2019, ka 10 vende vakant dhe konkretisht 5 janë në pozicionet drejtor drejtorie duke sjellë ngarkesë në funksionimin dhe realizimin e detyrave, gjë e cila ndikon direkt në cilësinë e punës së kryer. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 52-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1.Rekomandimi:

- Nga MASR, dhe të gjithë institucionet në varësi të saj (D.Arsimore. ZA/, Institucione të arsimit parauniversitar dhe IAL) të merren masa në bashkëpunim me DAP, për rikthimin e menjëhershëm në punë të të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë si dhe të ndërpritet procesi i largimeve nga puna në mënyrë të padrejtë dhe të njëanshme në arsim si një nga sektorët shtetërorë më të rëndësishëm të punësimit,

-Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të planifikojë dhe të analizojë në mënyrë korrekte, detyrimet e prapambetura që në fazat e PBA-së, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Drejtorinë e Koncesioneve, prokurimeve dhe Partneriteteve me qëllim shlyerjen e detyrimeve koherente, brenda vitit buxhetor dhe minimizimin e mbartjes së tyre në vitin pasardhës, duke nxjerrë shkaqet dhe përgjegjësitë e këtij veprimi të përsëritur cdo vit.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se veprimtaria e MASR-së, ka vijuar të funksionojë me Rregulloren e Brendshme të miratuar nga Ministri i MASR-së me urdhër nr. 2437, datë 09.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e MASR-së ”ndryshimi i fundit i së cilës është bërë me urdhër nr. 6290, datë 17.06.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e MASR-së ”. Ajo që konstatohet nga ristrukturimi i institucionit është një ndryshim në emërtim i drejtorive në tërësi, i varësive të tyre si dhe një rritje e madhe e numrit të sektorëve. Edhe pse MASR është ristrukturuar sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.163, datë 05.10.2017 “Mbi miratimin e strukturës dhe organikës së MASR”, kjo nuk është shoqëruar me ndryshimin korespondues në rregulloren e brendshme.

MASR ka funksionuar me rregulloren e vjetër ose e thënë ndryshe ka funksionuar “pa rregullore”, sepse struktura e re ka pasur një ndryshim total si në emërtim por edhe në funksione pasi numri i sektorëve në varësi të drejtorive përkatëse është rritur me 11, një rritje kjo që ka sjellë shtim të numrit të personelit, konkretisht 11 funksione përgjegjës sektori dhe rrjedhimisht një menaxhim jo eficient të burimeve njerëzore, e cila sjell mos delegim të detyrave duke ulur ndjeshëm misionin e pozicioneve drejtues në procesin e raportimit për detyrat funksionale.

Për vitin 2018, rezultoi se nuk ishte dërguar një plan vjetor nevojash për rekrutim për aparatit dhe disa institucione të varësisë së sistemit për shkak të propozimit të ristrukturimit të DAR/ZA-ve në Institucione të tjera jashtë shërbimit civil. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 52-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1.Rekomandimi:

-MASR të marrë masa për të analizuar dhe reflektuar me hollësi në Rregulloren e Brendshme, gjithë ndryshimet e ndodhura në strukturë; si dhe të detajojë përshkrimet e punës, në funksion të të kuptuarit nga punonjësit e institucionit marrëdhëniet ndërmjet strukturave administrative të veçanta, vendin që ato zënë në njësi; të njohurit me të drejtat dhe detyrimet, të cilat i korrespondojnë pozicioneve të tyre; si dhe të rifreskojë bazën ligjore mbi të cilën mbështeten në të veçanta brenda rregullores.

-Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në ministri të hartojnë planin e konsoliduar të nevojave për rekrutim për të gjithë sistemin përkatës që përfshin aparatit e tij dhe institucionet e varësisë”, brenda afatit të përcaktuar pra brenda muajit nëntor të vitit, sipas VKM nr. 108, datë 26.2.2014 “Për Planin Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil”.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: *Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik është konstatuar se:* Në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, përlllogaritja e fondit limit në disa raste nuk është përlllogaritur duke studiuar tregun apo burime të dhënash të tjera të cilat do të ndihmonin në përlllogaritjen më të saktë të fondeve por është bërë vetëm duke u bazuar në përvojën e mëparshme dhe duke marrë oferta të OE të cilët janë në dijeni të të dhënave të tenderit mbi sasinë dhe objektin e detajuar që prokurohet, nuk argumentohet se si u përzgjedhën operatorët ekonomikë që paraqitën ofertat lidhur me objektin e prokurimit, kjo për faktin se janë të njëjtët OE që kanë marrë pjesë dhe janë shpallur fitues të kontratës së prokurimit, veprime këto që cenojnë parimin e Ligjit për prokurimin publik ku përcaktohet: “.....në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik” lidhur kjo me transparencën që duhet të jetë një nga parimet themelore të AK, për çdo hap që ndjekin në procedurat e prokurimit publik.

Në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

-nga AK në kriteret e kualifikimeve, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, konstatohen raste me kërkesa që nuk nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik.

14.1.Rekomandimi:

Nga Autoriteti kontraktor, të merren masa që në procedurat që do zhvillohen në vazhdim në vendosjen e kriterëve kualifikuese të cilat nuk cenojnë parimin e Ligjit për prokurimin publik ku në procedurat e prokurimit publik, të sigurohet integritet, besim publik dhe transparencë, lidhur kjo me transparencën që duhet të jetë një nga parimet themelore të AK, për çdo hap që ndjekin në procedurat e prokurimit publik.

- çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën me objekt “*Rikonstrukcioni i institutit të zhvillimit të arsimit*”, konstatohet se në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”. Është kërkuar që Operatori ekonomik, duhet të ketë një eksperiencë në fushën e punimeve civile, si subjekt i licencuar, prej të paktën 10 vitesh. Licencën/licencat profesionale të operatorit ekonomik, si subjekt zbatimi për punimet civile, të cilat i kanë dhënë të drejtën për të ushtruar këtë veprimtari profesionale, përgjatë afatit kohor të kërkuar si eksperiencë (të paktën 10 vjet). Mbështetur në legjislacionin dhe rregullave të prokurimit publik, nuk parashikohet dispozitë ligjore vendosja e këtij kriteri, i cili ngushton konkurrencën. Referuar në vendimin e KPP nr. 406/2016, nr. 1008 prot. datë 25.04.2016, përcaktohet qartë se, kërkesa e periudhës *10 vjet përvojë* është i ekzagjeruar, si kriter diskriminues dhe pengues për një konkurrencë të hapur, pasi edhe një operator ekonomik me më pak se dhjetë vite eksperiencë, mund të provojë që realizon punën, nëse plotëson të gjitha kapacitetet ligjore, ekonomike e financiare, të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik dhe të detyrueshme për t’u përmbushur. Pavarësisht se eksperiencia në një fushë të caktuar është një element dhe kapacitet i rëndësishëm për të

vërtetuar aftësitë e një operatori ekonomik, kjo nuk duhet të lejojë autoritetin kontraktor të përcaktojë dhe të vendosë kritere të ekzagjeruara.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "*Rikonstruksioni i institutit të zhvillimit të arsimit*", konstatohet se nga AK është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikate ISO/IEC 27001:2013, e cila është e paargumentuar nga AK. Kjo certifikatë specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të *menaxhimit të sigurisë së informacionit*. Ai gjithashtu përfshin kërkesa për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës. Pra, siç shikohet kjo certifikatë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, pasi një OE që merret me ndërtime, rikonstruksion kjo certifikatë nuk i nevojitet.

- Certifikata EN ISO 50001:2011, e cila është e paargumentuar nga AK. ISO 50001: 2011 specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e *një sistemi të menaxhimit të energjisë*, qëllimi i të cilit është t'i lejojë një ndërmarrje të ndjekë një qasje sistematike në *arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë*, përfshirë efikasitetin e energjisë, përdorimin e energjisë dhe konsumin. ISO 50001: 2011 specifikon kërkesat e zbatueshme për përdorimin dhe konsumin e energjisë, duke përfshirë matjen, dokumentacionin dhe raportimin, hartimin dhe praktikën e prokurimit për pajisje, sisteme, procese dhe personel që kontribuojnë në performancën e energjisë.

- Në procedurën me objekti "*Rikonstruksioni i institutit të zhvillimit të arsimit*" Nga Ak është kërkuar Operatori ekonomik duhet të ketë një Mjek të ndërmarrjes. *Vendosja e këtij kriteri është pa lidhje me objektin e prokurimit*. Kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë, në zbatim të VKM nr. 742, datë 06.11.2003, është e shfuqizuar dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte vendosur si kriter kualifikues. Kërkesa e mjekut të ndërmarrjes e justifikuar nga Njësia e Prokurimit sipas pikës 12/2 të VKM nr. 742 datë 06.11.2003 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë"*" konstatohet se në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë"*, pika 1, pika 3, germa "b" dhe pika 4 germa "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "*Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë"*, shfuqizohet. Duke qenë se VKM nr. 742, datë 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001, rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar, duke qenë se, akti bazë nuk ka më fuqi ligjore. Pra nga, autoriteti kontraktor ka përcaktuar një kriter jo në përputhje me përcaktimet ligjore si më sipër cituar, pasi kërkesa që një shoqëri të ketë të një mjek në stafin e tij, nuk është sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë"*. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 90-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1.Rekomandimi:

- Nga Njësia e Prokurimit, të marrë masa që në procedurat që do zhvillohen në vazhdim në vendosjen e kritereve kualifikuese të mirë argumentohen. Nga Njësia e Prokurimit duhet të hartohen kritere kualifikuese në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik, duke siguruar përdorim me ekonomikitet, efektivitet dhe eficensë të fondeve publike, dhe eliminimin e kritereve kualifikuese të cilat janë diskriminuese dhe nuk nxisin konkurrencën në procedurat e prokurimit.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "*Shërbim Internetit në Sistemin Arsimor Parauniversitar*", konstatohet është vendosur si kriter kualifikues ndaj OE certifikata EN ISO 50001:2011, e cila është e paargumentuar nga AK. ISO 50001: 2011 specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është t'i lejojë një ndërrmarje të ndjekë një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, përfshirë efikasitetin e energjisë, përdorimin e energjisë dhe konsumin. ISO 50001: 2011 specifikon kërkesat e zbatueshme për përdorimin dhe konsumin e energjisë, duke përfshirë matjen, dokumentacionin dhe raportimin, hartimin dhe praktikën e prokurimit për pajisje, sisteme, procese dhe personel që kontribuojnë në performancën e energjisë. Pra, siç shikohet kjo certifikatë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, pasi OE do japi internet dhe do vendosi paisjet e përcaktuara në specifikimet teknike dhe termave të referencës dhe kjo certifikatë i nevojitet MARS.

- AK ka kërkuar që OE ketë të paktën 30 të punësuar inxhinierë: telekomunikacion ose/dhe elektronik të shpërndarë në territor, të garantuara këto me CV, kontrata pune, vërtetime të sigurimeve shoqërore dhe diploma dhe të vërtetoje praninë e një numri të konsiderueshëm punonjësish (mbi 300 punonjës), për sigurinë e një implementimi të shpejtë e sigurte. Listepagesat dhe vërtetimi për sigurimet shoqërore duhet të jenë për periudhën Tetor 2016-Mars 2017; të ketë të paktën 2 inxhinierë të pajisur me certifikate CompTia; të ketë të paktën 3 inxhinierë të pajisur me certifikate CCNA Certified Network Associate Routing & Sëitching; të ketë të paktën 3 inxhinierë të pajisur me certifikatë SCTE.

Kërkesa e mësipërme, nuk është argumentuar apo bazuar diku numri kaq i lartë i specialistëve, në lidhje me afatin, volumin dhe objektin e kontratës, duke zvogëluar ndjeshëm konkurrencën e operatorëve. Kërkesat e OE duhet të ketë për punonjësit me certifikatat që kanë bërë, duke i ndarë me kërkesa kualifikuese teknike, e cila përbën deri diku diskriminim të operatorëve ekonomik, duke mos arsyetuar vendosjen kryesisht të certifikatave, me volumin e shërbimit që ka secili prej kërkesave të vendosura, pasi nuk mund të ekzistojnë disa operatorë ekonomik garues, që të zotërojnë të gjitha "trajnimet dhe certifikatat" e kërkuara në formë kërkesa kualifikuese.

- Në këtë procedurë me shkresën nr. 4734 prot. Datë 09.05.2017, paraqitet ankesë pranë AK nga OE mbi kriteret kualifikuese, ku sqaron se në specifikimet teknike, pika e demarkacionit thuhet: Konfigurimi dhe aktivizimi i shërbimit do të bëhet nga kontraktuesi si për rastin e PC dhe rrjetin LAN, po ashtu edhe për PC apo laptop të tjerë. Ofertuesit duhet të bëjnë konfigurimin për pjesën fundore të ofrimit të shërbimit në mjediset e shkollave institucioneve, në laboratorët informatikë dhe PC të tjera ku do të ofrohet shërbimi internet për informatikë dhe PC të tjera ku do të ofrohet shërbimi Internet për periudhë 14 mujore, duke filluar nga data më e hershme e mundshme, e ofrimit të shërbimit nga kontraktuesi, por pa kaluar 10 javë nga data e nënshkrimit të kontratës. Pra ky operator sqaron se :Afati i implementimit të projektit 10 javë 10 x 6 ditë pune, në total 60 ditë. $1109 \text{ instalime} / 60 \text{ ditë} = 18.5 \text{ instalime në ditë}$. $300 \text{ punonjës} / 18.5 \text{ instalime në ditë} = 16.2 \text{ punonjës për një instalim në ditë}$. Për maksimumin e instalimit mund të jetë 5 persona për 1 instalim x 19 instalime në ditë, në total 95 personel teknik për të kryer instalimet. 95 persona (instalatorë) + 30 inxhinierë + 20 Help desk, në total për implementimin e projektit nevojiten 145 persona.

Nga MARS, konstatohet mospërdorim i mirë i fondeve publike në kundërshtime ligjore mbi rregullat e prokurimit publik, duke mos rritur eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoriteti kontraktor. MARS, nuk ka siguruar mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale, nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, nuk ka nxitur konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe nuk ka siguruar një trajtim të barabartë për të gjithë operatorët bazuar kriteret kualifikuese të padrejta. Ofertat më e leverdishme e BOE "A...." sh.a & "A...." sh.p.k me vlerë

129,021,000 lekë, kanë qenë më e leverdishme për MARS, në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe eficensës, bazuar kriterëve të vlerësimit që është çmimi më i ulët. Pra nëse autoriteti kontraktor nuk do kishte përcaktuar kriteret e sipërcituara në DST, duke vendosur kriterë që të nxisin konkurrencën dhe duke vlerësuar çmimin më të ulët, atëherë AK do të kishte mundur të kursente fondet publike me vlerë më të ulët prej 39,581,023 lekë me TVSH (162,005,186 lekë - 129,021,000 lekë = 32,984,186 lekë x 20%), midis diferencës ofertës së "A...."SH.A dhe ofertën e bashkimit të Operatorëve Ekonomik "A...." sh.a & "A...." sh.p.k. (Trajtuar më hollësisht në faqet 90-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1.Rekomandimi:

- Nga MARS në shërbimet e internetit të marrë masa që në procedurat që do zhvillohen në vazhdim në vendosjen e kriterëve kualifikuese të mirë argumentohen. Nga Njësia e Prokurimit duhet të hartohen kriterë kualifikuese në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik, duke siguruar përdorim me ekonomicitet, efektivitet dhe eficensë të fondeve publike.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në objektin "Rikonstruksioni i shkollës së mesme Jakov Xoxa, Bashkia Fier", konstatohet se nga AK janë vendosur kërkesa për kualifikim në mënyrë të tillë që nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat e veçanta të kualifikimit nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Nga AK është kërkuar Operatori ekonomik duhet të ketë një Mjek të ndërmarrjes. Kërkesa që Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë, në zbatim të VKM nr. 742, date 06.11.2003, është e shfuqizuar dhe për këtë arsye nuk duhej të ishte vendosur si kriter kualifikues.

- Nga vlerësimi i ofertave, lidhur me Bashkimi i Operatoreve ekonomike "J.... & 2...." shpk, konstatohet se ky operator ekonomik do të shpallej i suksesshëm nëse nga AK nuk do të vendoseshin kriterë të sforcuara që të nxisnin pjesëmarrjen. Në përputhje me LPP neni 53 pika 4 citon se: "Ak vlerëson një ofertë të vlefshme dhe nëse ajo përmban devijime të vogla të argumentuara të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të përcaktuara në DT, si dhe gabime shtypi të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj", duhej të merrte parasysh ofertën ekonomikisht më të ulët, bazuar çmimit më të ulët, pasi arsyet e s'kualifikimit nuk do të ndikonin në realizimin me sukses të kontratës. Pra nëse AK do të vendoste kriterë kualifikuese në përputhje me objektin, volumin e kontratës të cilat duhej të lidheshin ngushtë me kriteret kualifikuese do të kishte të mundur të kursente dhe të mire administronte fonde publike. Oferta më e leverdishme e BOE "J..... sh.p.k & 2..... sh.p.k", me vlerë 25,599,482 Lekë pa TVSH, kanë qenë më e leverdishme për Bashkinë Fier, në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe eficensës, bazuar kriterëve të vlerësimit që është çmimi më i ulët. Mos plotësimi i pikave në raportin e KVO, nga operatorët ekonomik nuk do të cenonte objektin e prokurimit pasi kërkesat kualifikuese rezultuan të tepërta dhe jo në përputhje me LPP. Diferenca e vlerës prej 7,486,293 lekë me TVSH (31,838,060 lekë - 25,599,482 lekë = 6,238,578 lekë x 20%), midis ofertës së "Jogi sh.p.k & 2Z Konstruksion sh.p.k", dhe ofertën e Operatorit Ekonomik "Kola Invest" sh.p.k, përbën efekt financiar jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficensës, të shkaktuar nga kriteret kualifikuese të sforcuara, të cilat rezultuan jo në përputhje me volumin e punimeve dhe jo në stimulim apo nxitje të konkurrencës. (Trajtuar më hollësisht në faqet 90-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1.Rekomandimi:

- Nga Bashkia Fier duhet të hartohen kritere kualifikuese në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik, duke siguruar përdorim me ekonomikitet, efektivitet dhe eficensë të fondeve publike.

Në vijimësi

18.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i shkollës “Jakov Xoxa” të kryer sipas kontratës së punimeve nr. 6186/7 datë 14.09.2018 është nënshkruar midis AK bashkisë dhe OE “K... Invest” me vlerë 38,205,671 me TVSH. Lidhur zbatimin e kontratës u konstatua se punimet nuk janë realizuar dhe shkolla ndodhet në kushtet pa ndricim dhe pa ujë. Kjo për shkak të Vendimit nr. 7 datë 11.05.2018 “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja I, për vitin 2018, grantet “Arsimi” paragrafi Shënime, në pikën 1 është përcaktuar se “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën e plotë të zbatimit të punimeve sipas projektit (paraqitur nga aplikuesi sipas fazës/projektit që financohet). Diferenca midis vlerës së projektit me vlerën e kontratës (nëse ka një të tillë, pas prokurimit publik dhe mbas nënshkrimit të saj), do t’i zbritet financimit me burim grantet “Arsim”, pjesë e buxhetit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Por në fakt vlera e plotë e miratuar sipas Vendimit nr. 7 datë 11.05.2018 të komisionit të zhvillimit rajoneve është 63,197,856 lekë.

- Kontratohet se nga Bashkia Fier janë shkelur rregullat e bashkëfinancimit, duke krijuar konfuzion pasi ka realizuar një ndarje të projektit, ku punimet ndërtimore do të realizohen nga OE fitues në prokurim dhe punimet elektrike e hidraulike nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike. Ndarja e punimeve të objektit është në kundërshtim të plotë me ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, me Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Bashkinë Fier. Legjislacioni i punimeve mbi zbatimin e punimeve, pasqyron qartazi se në një objekt, ku jepet leja e ndërtimit, dorëzimi i sheshit të ndërtimit, nuk mund të ndërhyjë palë të treta si Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, për instalimet elektrike, hidraulike dhe MKZ. Referuar projekt-preventivit të punimeve dhe sipas kushteve të zbatimit të punimeve, shumë zëra ndërtimore nuk mund të realizohen pa shtrirje e linjave dhe tubacioneve elektrike, hidraulike etj. Pra nuk mund të realizohen pllakat, suvaja, tavanet etj, pa u realizuar instalimet elektrike që duheshin realizuar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, por të cilat janë realizuar nga sipërmarrësi i punimeve me kostot e tij vetëm me qëllim përfundimin e punimeve ndërtimore.

Nga shkelja e rregullave të bashkëfinancimit konstatohet se shkolla e mesme Jakov Xoxa, nuk është përfunduar akoma, ku nuk ishin realizuar punimet elektrike dhe hidraulike. Nga Janari 2019 deri në Tetor 2019, shkolla nuk ishte në funksion të normave dhe standardeve të mësimdhënies pasi mungonte energjia elektrike dhe uji në tualete. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 90-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1.Rekomandimi:

-MASR pavarësisht se diferenca midis vlerës së projektit me vlerën e kontratës (pas prokurimit publik dhe mbas nënshkrimit të saj), i zbritet financimit me burim grantet “Arsim”, dhe është pjesë e buxhetit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në bashkëpunim me Bashkinë Fier duhet të marrin masa të menjëhershme, për zgjidhjen e situatës për përfundimin e rikonstruksionit së shkollës Jakov Xoxa, duke siguruar fondet e mbetura, për tu financuar me qëllim që shkolla të vihet në kushte normale të funksionimit të saj.

Në vijimësi

19.Gjetje nga auditimi: Nga krahasimi i të dhënave të pasqyruara në lidhje me vitin e mëparshëm gjatë raportimit të pasqyrave financiare të vitit 2018, me pasqyrat financiare të

dorëzuara për vitin 2017 konstatohet se ka diferenca. Kështu nëse të ardhurat jo tatimore për vitin 2017 rezultojnë në shumën 13,744 mijë lekë , në krahasimin dy vjeçar të pasqyrave të vitit 2018, kjo llogari rezulton në shumën 86,035 mijë lekë, ose 72,291 mijë lekë më shumë. Posti “Të ardhura jo tatimore” midis dy pasqyrave konstatohet se ka ndryshime në Llogaritë 7111, “Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh”, Llog. 7113 “Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve” dhe Llog. 719 “Të ardhura të tjera jo tatimore”. Diferenca konstatohen edhe në zërin e rezultatit të veprimtarisë, ku sipas kësaj pasqyre, për vitin e mëparshëm 2017 rezultati i periudhës është 83,993 mijë lekë, ndërsa sipas pasqyrave financiare të vitit 2017 kjo rezulton 0. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, Neni 10, 11. (*Trajtuar më hollësisht në faqet 90-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1.Rekomandimi: MASR të marrë masat e nevojshme në sistemimin e diferencave të të ardhurave dhe rezultatit të veprimtarisë së institucionit për vitin 2017.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se vlera e detyrimeve të mbartura dhe ato të krijuara rishtazi për MASR-në (përfshirë gjithë sistemin arsimor) deri më 31.12.2018 ka një rritje dhe kjo vjen jo si pasojë e detyrimeve të aparatit por si shkak i rritjes së detyrimeve në IAL-publike. Nga IAL publike për vitin 2018, konstatohet një rritje e detyrimeve të prapambetura afro 3 herë më shumë në krahasim me një vit më parë. Nga viti 2017, IAL publike trashëguan në vitin 2018 detyrime në masën 93.3 milion lekë, dhe në fund të periudhës 2018, detyrimet janë realizuar nga:

-Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, në shumën prej 231.3 milion lekë ose 92 % të detyrimeve totale të raportuara.

-Universiteti i Tiranës në shumën prej 12.2 milion lekë ose 4.8 % të detyrimeve te pa likuiduara.

-Universiteti i Mjekësisë Tiranë në shumën prej 1.2 milion lekë ose 0.5% të detyrimeve te pa likuiduara.

-Institucionet e tjera publike nuk kanë detyrime financiare të krijuara rishtazi për vitin 2018.

Pra sikurse konstatohet peshën kryesore ose 92 % të detyrimeve totale e zë UAMD.

Deri në shtator të viti 2019, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, ka detyrime të palikuiduara në vlerën 242.7 milion lekë. Në këtë vlerë shuma prej 196,818,132 lekë e zë kontrata në lidhje me punimet ndërtimore për ndërtimin e kampusit të ri universitar dhe pajisja e godinës së re me orenditë e nevojshme.

Kontrata e parë është ajo me nr. 910/6.prot , datë 24.01.2013 ”Për ndërtimin e kampusit të ri Universitar” si dhe godina e dytë për Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, shtesa. Kjo kontratë ka pasur vlerë fillestare 636,303,341 lekë dhe shtesë kontrate prej 113,000,638 lekë, pra në total një vlerë prej 749,303,979 lekë.Nga MASR në lidhje më këtë kontratë janë paguar nga buxheti i shtetit vlera 285,519,009 lekë dhe nga të ardhurat e universitetit është paguar vlera 260,061,761 lekë.Vlera e mbetur për të cilën Universiteti është debitor deri në dhjetor 2018, është 203,723,210 lekë. Universiteti i Durrësit vazhdon të ketë përsëri akumulim të detyrimeve të prapambetura sepse përgjatë 9-mujorit të parë të vitit aktual 2019, nga granti i miratuar për mbështetjen studentore, 88,900,000 lekë janë përdorur për rimbursimin e tarifave të shkollimit.

MASR shprehet se : Bazuar në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, këto institucione gëzojnë autonomi financiare dhe shlyerja e detyrimeve të krijuara rishtazi realizohet nga të ardhurat e krijuara nga këto institucione dhe jo nga fondet buxhetore, por nisur nga situata që paraqitet tek Universiteti i Durrësit rezulton që detyrimet vijnë duke u rritur dhe në lidhje me këto nga buxheti i shtetit janë paguar 285,5 mln lekë dhe nga të ardhurat e universitetit janë paguar 260 mln lekë . Nisur nga të ardhurat që ky institucion mbledh probabiliteti më i madh është

që këto detyrime të vazhdojnë të paguhen nga buxheti i shtetit dhe jo nga të ardhurat e krijuara nga ky institucion, duke e rënduar përherë e më shumë atë.

Për periudhën 2016-2018, nga fondi i të ardhurave të Universitetit janë paguar 127,188,405 lekë vetëm për orët e zhvilluara mbi normë nga personeli akademik. Nisur nga të ardhurat që IAL realizojnë për periudhën në auditim konstatohet se këto të ardhura janë shumë më të vogla në raport me shpenzimet që këto universitete kanë dhe konkretisht situatë problematike paraqitet tek UAMD, Universiteti i Vlorës, Universiteti i Shkodrës, Universiteti i Korçës dhe Universiteti I Sporteve. Për sa më sipër nuk ka një analizë të detajuar në lidhje me Universitetin e Durrësit, si nga MASR ashtu edhe nga Administratori dhe Bordi I këtij Universiteti nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efizienzë. Nuk ka një planifikim të mirëfilltë të ardhurash ku të parashikohet me afate konkrete mënyra se si do të ulet ky detyrim, si dhe nuk ka nxjerrje përgjegjësi as nga Ministria e Arsimit e as nga Bordi i Universitetit, kur jemi përpara një fakti të pamohueshëm që ky borxh do të vazhdojë të rëndojë buxhetin e Shtetit, edhe pse Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, iu jep autonomi financiare, dhe shlyerja e detyrimeve të krijuara rishtazi realizohet nga të ardhurat e krijuara nga këto institucione dhe jo nga fondet buxhetore. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 75-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1.Rekomandimi:

MASR në bashkëpunim më UAMD(Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës) të ngrejë një grup punë që të kryejë një analizë të hollësishme ku të detajohet detyrimi i krijuar që në gjenezë në lidhje me kontratën e ndërtimit dhe mobilimit të Universitetit, si dhe të nxirren përgjegjësitë për veprimet dhe mosveprimet për rastin konkret duke përpiluar një plan masash dhe afatesh të mirë përcaktuara për ndarjen dhe pagimin e këtij borxhi gjithnjë e në rritje.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN, MENAXHIMIN PA EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

C.1.Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, për shumën 316,910,644 leke.

1-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, për shumën 316,910,644 leke, nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore e ndarë ;

-Aparati i MASR nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore shuma është në vlerë 46,699,644 lekë.

-Ndërkohë për njësitë e tjera shpenzuese ku përfshihen Njësitë Arsimore vendore, IAL si dhe Institucione të tjera varësie kjo shumë është në vlerë 270,211,000 lekë.

Konkretisht nga ana e MASR u konstatua se sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe likuidimet e kryera nëpërmjet bankës, vlera për likuidim për 11 punonjës të larguar padrejtësisht nga puna është në shumën 46,699,644 lekë për periudhën në auditim. Shumat e detyrimeve për vendimet gjyqësore të paguara nga buxheti i shtetit për vitin 2017 janë në vlerën 20,646,317 lekë dhe për vitin 2018 në vlerën 21,086,268 lekë, dhe mbetur për tu shlyer në 2019 vlera prej 4,967,059 lekë. Për të gjitha këto vendime edhe pse kanë qenë të formës së prerë, të gjitha pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga MASR, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbauesit privat, ku është paguar nga buxheti i shtetit kosto shtesë në shumën prej 2,401,276 lekë për tarifa përmbaresh.

Sipas planit të masave të marrë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura që vijnë nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me shkresën nr. 9971/7, datë 20.9.2018, si dhe shkresën nr. 11422/1, datë 14.11.2018 të destinuar për likuidimin e

vendimeve gjyqësore të formës së prerë, MASR ka kërkuar fonde shtesë për likuidim të vendimeve për Drejtoritë dhe Zyrat Arsimore, në vlerë totale 70,701,105 lekë.

Në mënyrë të përmbledhur vetëm MASR për një periudhë 4 vjeçare ka realizuar pagesa për likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për periudhën 2014-2018, në masën 163,690,000 lekë.

Njësitë e tjera shpenzuese ku përfshihen Njësitë Arsimore vendore, IAL si dhe Institucione të tjera varësie kjo shumë është në vlerë 856,238,000 lekë. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 90-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi:

a) Institucioni i MASR të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për shumatat e shpenzuara sa më lartë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, si shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit dhe të mos lejojë kryerjen e pagesave të kësaj kategorie pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë.

Në vijimësi

C.2.Shpenzime joefektive për buxhetin e shtetit, për shumën 47, 067,316 leke në fushën e prokurimit publik

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për vitin 2017, në procedurën e prokurimit me objekt "Shërbim Internetit në Sistemin Arsimor Parauniversitar", konstatohet se MARS, nuk ka siguruar mirë përdorim të fondeve publike, nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe nuk ka siguruar një trajtim të barabartë për të gjithë operatorët bazuar kryesisht në kualifikueset të padrejta. Ofertat e BOE "A...." sh.a & "A...." sh.p.k me vlerë 129,021,000 lekë, kanë qenë më e leverdishme për MARS, në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe eficensës, bazuar kryesisht në vlerësimin që është çmimi më i ulët. Pra nëse autoriteti kontraktor nuk do kishte përcaktuar kriteret e sipërcituara në DST, duke vendosur kriteret që të nxisin konkurrencën dhe duke vlerësuar çmimin më të ulët, atëherë AK do të kishte mundur të kursente fondet publike me vlerë më të ulët prej 39,581,023 lekë me TVSH (162,005,186 lekë - 129,021,000 lekë = 32,984,186 lekë x 20%), midis diferencës ofertës së "A....."sh.a dhe ofertën e bashkimit të Operatorëve Ekonomik "A....." sh.a & "A....." sh.p.k. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 90-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.2.Rekomandimi:

- Nga MARS, të marrin masa, të analizojë me grup pune të vecantë, shaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve në shumën prej 39,581,023 lekë, pa efektivitet, pa eficensë dhe pa ekonomicitet.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i shkollës së mesme Jakov Xoxa, Bashkia Fier", konstatohet se nga Ak janë vendosur kërkesa për kualifikim në mënyrë të tillë që nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat e veçanta të kualifikimit nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Nëse AK do të vendoste kriteret kualifikuese në përputhje me objektin, volumin e kontratës të cilat duhej të lidheshin ngushtë me kriteret kualifikuese do të kishte mundur të kursente dhe të mire administronte fonde publike. Oferta më e leverdishme e BOE "J.....sh.p.k & 2..... sh.p.k", me vlerë 25,599,482 Lekë pa TVSH, kanë qenë më e leverdishme për Bashkinë Fier, në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe eficensës, bazuar kryesisht në vlerësimin që është çmimi më i ulët. Diferenca e vlerës prej 7,486,293 lekë me TVSH (31,838,060 lekë - 25,599,482 lekë = 6,238,578 lekë x 20%), midis ofertës së "J.... sh.p.k & 2..... sh.p.k", dhe ofertën e Operatorit Ekonomik "K..." sh.p.k, përbën efekt financiar shkaktuar nga kriteret kualifikuese të sforcuara, të cilat rezultuan jo në përputhje me volumin

e punimeve dhe jo në stimulin apo nxitje të konkurrencës. (Trajtuar më hollësisht në faqet 90-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.3.Rekomandimi

- Nga Bashkia Fier, të marren masa, të analizojë me grup pune të vecantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve në shumën prej 7,486,293 lekë, pa efektivitet, pa eficensë dhe pa ekonomikitet.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE:

Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe pikës 11, Kreu II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore dhe si dhe VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” i ndryshuar, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandojmë Ministrit të Arsimit dhe Sporteve, që të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe sipas vlerësimit, ti kërkojë Komisionit disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Largim nga shërbimi civil”, “Vërejtje” deri “Ulje në detyrë” për punonjësit e mëposhtëm:

-Për znj **O K** rejomandojmë “Largim nga Shërbimi civil” me detyrë, drejtore e Drejtorisë së Prokurimeve Publike dhe Koncesioneve si dhe Koordinator i projektit E-Twinning.

Pasi nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për vitin 2017, në procedurën e prokurimit me objekt “Shërbim Internetit në Sistemin Arsimor Parauniversitar”, konstatohet se MARS, nuk ka siguruar mirë përdorim të fondeve publike, nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe nuk ka siguruar një trajtim të barabartë për të gjithë operatorët bazuar kritereve kualifikuese të padrejta. Ofertat e BOE “Abissnet” sh.a & “Abcom” sh.p.k me vlerë 129,021,000 lekë, kanë qenë më e leverdishme për MARS, në përputhje me parimet e ekonomikitetit dhe eficensës, bazuar kritereve të vlerësimit që është çmimi më i ulët. Pra nëse autoriteti kontraktor nuk do kishte përcaktuar kriteret e sipërcituara në DST, duke vendosur kritere që të nxisin konkurrencën dhe duke vlerësuar çmimin më të ulët, atëherë AK do të kishte mundur të kursente fondet publike me vlerë më të ulët prej 39,581,023 lekë me TVSH midis diferencës ofertës së “Albtelecom”sh.a dhe ofertën e bashkimit të Operatorëve Ekonomik “Abissnet” sh.a & “Abcom” sh.p.k.

1.**A K**, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlersimit në procedurat e prokurimit publik.

2.**A Sh**Përgjegjës i Sektorit Financës dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlersimit në procedurat e prokurimit publik.

3.**E T** në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlersimit

4.**B A**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlersimit

5.**B R**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlersimit

6.**A F** në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlersimit

7.**R M** në cilësinë e anëtarit të Grupit i hartimit Kritereve Teknike

8. **K Rr** në cilësinë e anëtarit të Grupit i hartimit Kriteve Teknike dhe Njësisë së Prokurimit
9. **L B** në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit
10. **I B** në cilësinë e anëtarit të Grupit i hartimit Kriteve Teknike dhe Njësisë së Prokurimit
11. **A T** në cilësinë e anëtarit të Grupit i hartimit Kriteve Teknike
12. **D N** në cilësinë e anëtarit të Grupit i hartimit Kriteve Teknike dhe Njësisë së Prokurimit
13. **I S** në cilësinë e anëtarit të Grupit i hartimit Kriteve Teknike dhe Njësisë së Prokurimit
14. **D Gj** në cilësinë e anëtarit të Grupit i hartimit Kriteve Teknike dhe Njësisë së Prokurimit

15. **D V** në cilësinë e anëtarit të Grupit i hartimit Kriteve Teknike dhe Njësisë së Prokurimit
16. **A C** në cilësinë e anëtarit të Grupit i hartimit Kriteve Teknike dhe Njësisë së Prokurimit.
Pasi në procedurat e prokurimeve publike, për punë publike, blerjen e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve për vitin 2017 dhe vitin 2018, si dhe 8 mujorin e vitit 2019 të përzgjedhura nga audituesit, është konstatuar se në MASR, si Autoritet Kontraktor, në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, përlllogaritja e fondit limit në disa raste nuk është përlllogaritur duke studiuar tregun apo burime të dhënash të tjera të cilat do të ndihmonin në përlllogaritjen më të saktë të fondeve por është bërë vetëm duke u bazuar në përvojën e mëparshme dhe duke marrë oferta të OE të cilët janë në dijeni të të dhënave të tenderit mbi sasinë dhe objektin e detajuar që prokurohet, nuk argumentohet se si u përzgjedhën operatorët ekonomikë që paraqitën ofertat lidhur me objektin e prokurimit, kjo për faktin se janë të njëjtët OE që kanë marrë pjesë dhe janë shpallur fitues të kontratës së prokurimit, veprime këto që çenojnë parimin e Ligjit për prokurimin publik ku përcaktohet: “.....në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit public” lidhur kjo me transparencën që duhet të jetë një nga parimet themelore të AK, për çdo hap që ndjekin në procedurat e prokurimit publik.

Në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriteve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

-nga AK në kriteret e kualifikimeve, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, konstatohen raste me kërkesa që nuk nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik.
-parashikimet e nenit 46 të LPP, si dhe nenit 26 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014, ku çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore.

E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte në **“Largim nga Shërbimi civil”** për **Z. P N**, me detyrë dhe në cilësinë e ish- Sekretarit të Përgjithshëm MASR-s.

Pasi nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për vitin 2017, në procedurën e prokurimit me objekt “*Shërbim Internetit në Sistemin Arsimor Parauniversitar*”, konstatohet se MARS, nuk ka siguruar mirë përdorim të fondeve publike, nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe

nuk ka siguruar një trajtim të barabartë për të gjithë operatorët bazuar kriterëve kualifikuese të padrejta. Ofertat e BOE “A.....” sh.a & “A.....” sh.p.k me vlerë 129,021,000 lekë, kanë qenë më e leverdishme për MARS, në përputhje me parimet e ekonomicitetit dhe eficensës, bazuar kriterëve të vlerësimit që është çmimi më i ulët. Pra nëse autoriteti kontraktor nuk do kishte përcaktuar kriteret e sipërcituara në DST, duke vendosur kriteret që të nxisin konkurrencën dhe duke vlerësuar çmimin më të ulët, atëherë AK do të kishte mundur të kursente fondet publike me vlerë më të ulët prej 39,581,023 lekë me TVSH midis diferencës ofertës së “A.....”sh.a dhe ofertën e bashkimit të Operatorëve Ekonomik “A....” sh.a & “A.....” sh.p.k.

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, MASR, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

c. Raporti përfundimtar i auditimit, t’i përcillet për dijeni, Kuvendit të Shqipërisë dhe Kryeministrit të Shqipërisë.

G. MBI PROGRAMIN E DOKTORATURAVE.

Në vijim të auditimit të mëparshëm për procesin e doktoraturave si dhe Vendimit nr.84 datë 30.06.2015 të Kryetarit të KLSH-s(*pasi ky aspekt nuk u trajtuan në këtë auditim*) janë rekomanduar propozime për përmirësime ligjore lidhur me rolin që MASR duhet të ketë në vendosjen, plotësimin dhe mbajtjen e standardeve të larta dhe unifikuese për këtë cikël studimi në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë në vend, inkurajojmë përcaktimin e qartë të kompetencave monitoruese të Ministrisë, duke synuar forcimin e rolit të këtij institucioni në mbarëvajtjen e programeve të ciklit të tretë të studimeve, i cili në gjykimin tonë fillimisht duhet të jetë cikël studimi me kohë të plotë. Të theksohet detyrimi për krijimin e një database të veçantë, të unifikuar dhe përditësuar ku të jepen të dhëna për udhëheqësit, temat e doktoraturave dhe reçencat, i cili të jetë publik dhe i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit. Ligji duhet të ketë instrumente kontrolli publik të shoqëruara me identifikim/përcaktim përgjegjësie individuale dhe institucionale për proceset e fitimit/miratimit të titujve akademik, duke synuar rregullimin e plotë dhe afatgjatë të kërkimit shkencor dhe etapave/kushteve të përparimit në karrierën akademike. Gjithashtu në ligj dhe në aktet nënligjore të përcaktohen kompetencat kufizuese të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, në të gjitha rastet kur konstatohen parregullsi apo nivel i ulët i plotësimin të standardeve të përcaktuara apo kriterëve të detyrueshme të vendosura për çdo Institucion Publik apo Privat të Arsimit të Lartë, duke specifikuar qartë për çdo fazë të monitorimit llojin e kufizimit dhe masën e tij.

Gjithashtu MASR i është rekomanduar marrja e masave organizative lidhur me:

Inicimin e një inspektim i plotë për standardet dhe kushtet e akreditimit të ciklit të tretë të studimeve për të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë, duke synuar vlerësimin e studimeve të ofruara (modulet, profesorët e përfshirë dhe tekstet e studimit), raportet studentë/staf i brendshëm akademik, vlerësimin e gradave që janë fituar gjatë vitit 2012 e në vijim,

nëpërmjet kontrollit të cilësisë së kërkimit dhe plotësimi i kërkesave për mbrojtjen e gradës shkencore, si dhe rishikimin mbi kushtet dhe afatet (mbase duhet kufij të poshtëm të moshës) e fitimit të titujve të tjerë akademikë kjo në funksion të garantimit të cilësisë së stafëve dhe punës akademike por dhe në funksion të uljes së inflacionin në këtë proces të rëndësishëm me efekte financiare për buxhetin e shtetit (çdo titull ka efekt në fondin e pagave që mbulohet nga buxheti i shtetit), efekt i cili duhet të ishte vlerësuar nga MAS. Inkurajojmë, çdo ndërhyrje që rrit përgjegjësinë institucionale para ligjit për çdo devijim që ka pasoja të shumëfishta për tani dhe brezat që vijnë.

Në vendimin e Kryetarit të KLSH-s është kërkuar që Ministria të përcaktojë dhe publikojë kalendarin e akreditimit dhe rankimit të IAL-ve dhe programeve të tyre në të gjitha ciklet, të bashkëpunojë me strukturat drejtuese në IAL-të publike për zhbllokimin e situatës në ciklin e tretë të studimeve dhe të nxjerrë të gjithat aktet nënligjore e rregullative të nevojshme për të liberalizuar filtrin hyrës dhe forcuar filtrin dalës të doktorantëve potencialë. Ministria të marrë të gjitha masat, që në asnjë rast të mos ketë bllokim të përgjithshëm të kuotave të pranimit për programet e doktoraturës në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë dhe orientim të kuotave për Institucionet private të Arsimit të Lartë.

Për sa më lartë pavarësisht përpjekjeve për hartimin e akteve ligjore rregulluese të këtij procesi, konstatohet se ende vazhdon një situatë bllokuese në IAL publike dhe jopublike për miratimin e kuotave të studimeve doktrale, nga MASR.

Për sa trajtuar më sipër rekomandojmë :

Nga MASR për vitin akademik 2019-2020 të merren masa të menjëhershme për kompletimin dhe miratimin e akteve ligjore të nevojshme, për të hapur rrugë përgatitjes së universiteteve për fillimin e programeve doktrale, të orientuara te kërkimi i thelluar shkencor, etika dhe ndershmëria akademike dhe respektimi i pronës intelektuale të kërkuesve, për të kthyer në kushte normale këtë proces dhe mos vijuar me situatën bllokuese të tyre.

Menjëherë

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R